

EU4GREEN

PËRMBLEDHJE INFORMUESE PËR AGJENDËN E GJELBËR

EU4Green mbështet Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën*, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë drejt zbatimit të Agjendës së Gjelbër. Qëllimi i tij është ndërtimi i sinergjive, inkurajimi i ideve të reja, përmirësimi i cilësisë së vendimeve, duke çuar drejt zhvillimit të reformave rregullatore si dhe nxitjes efektive të proceseve të monitorimit dhe raportimit.

Për të arritur objektivat e caktuara, EU4Green do të forcojë komunikimin dhe bashkëpunimin midis vendimmarrësve, institucioneve kryesore rajonale si dhe palëve të interesit.

With funding from



Funded by
the European Union



Austrian
Development
Cooperation

umweltbundesamt^U
ENVIRONMENT AGENCY AUSTRIA

OBJEKTIVAT KRYESORE TË EU4GREEN

EU4Green do të kontribuojë në rajon për:

Tranzicionin drejt një “Ekonomie Qarkulluese (Qarkore)”: E përshtatur për çdo ekonomi, EU4Green do të forcojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve si dhe do të kontribuojë për parandalimin e mbetjeve duke mbështetur zhvillimin e planeve parandaluese të mbetjeve, duke nxitur kështu zhvillimin drejt një ekonomie qarkulluese (qarkore), modeleve të reja të biznesit si dhe rritjes së kapaciteteve.

Monitorimin dhe Reduktimin e Ndotësve:

- **Ajri:** Me qëllim përmirësimit të Cilësisë së Ajrit, EU4Green do të ketë në fokus zhvillimin e planeve për cilësinë e ajrit, duke patur në vëmendje ndotjen e ajrit në ambientet e brendshme, djegien e mbetjeve në bujqësi si dhe monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve.
- **Uji:** Me qëllim mbrojtjen e burimet ujore dhe forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave, EU4Green do të ketë në fokus përmirësimit të cilësisë së ujit duke mbështetur zbatimin e Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane dhe Nitrateve, si dhe përmirësimit të monitorimit të ujit.
- **Toka:** Me qëllim mbështetjen për identifikimin dhe rehabilitimin e tokës dhe zonave të ndotura të cilat përbëjnë rrezik për shëndetin dhe mjedisin, EU4Green do të japë përparësi mbrojtjes dhe shëndetit të tokës.

Përmirësimit të sistemeve të qëndrueshme dhe rezistente ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi:

Me qëllim reduktimin e ndotësve dhe forcimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit si dhe depozitimit të tij, EU4Green do të ketë në fokus menaxhimin efikas të ushqyesve si dhe zbatimin e Direktivës së Nitrateve. Projekti, gjithashtu do të ketë në vëmendje, zbatimin e Indikatorëve (treguesve) Agro-Mjedisorë për sisteme më të forta monitoruese.

Ruajtjen e Biodiversitetit: Me qëllim mbrojtjen e habitateve të rëndësishme ekologjike, duke përdorur planet e veprimit në zonat e mbrojtura, do të bëhet identifikimi i vendqëndrimeve pilote, mbledhja e të dhënave thelbësore si dhe hartimi i gjeo-databazave specifike që kanë lidhje me projektin. Nëpërmjet veprimtarive ndërkufitare, EU4Green do të forcojë bashkëpunimin e Ballkanit Perëndimor duke ruajtur biodiversitetin.

Forcimin e mekanizmave Monitorues dhe Raportues në Agjendën e Gjellbër: Me qëllim rritjen e efikasitetit të monitorimit dhe raportimit ekzistues kombëtar në Agjendën e Gjellbër, EU4Green do të analizojë përmbajtjen dhe funksionimin e tyre. Duke u bazuar në sa më sipër, do të zhvillohet një udhërrëfyes për kuadrin monitorues dhe raportues.

Përmirësimit të përvetësimit (të kuptuarit) të

Agjendës së Gjellbër nëpërmjet Aktiviteteve Komunikuese: Objektivi i EU4Green është të rrisë ndërgjegjësimin publik sa i përket rëndësisë dhe objektivave të Agjendës së Gjellbër, duke evidentuar përfitimet e saj si dhe duke dhënë shembuj të praktikave më të mira për zbatimin e saj.

Zhvillimin e Edukimit të Gjellbër: Do të prezantohet metoda inovative e të mësuarit, me fokus zhvillimin e moduleve shtesë (mikrokredenciale) në bashkëpunim me iniciativën e Reformës për Edukim të Evropës Juglindore. Këto module janë hartuar për të zhvilluar aftësitë kritike të gjelbra duke përfshirë fushat kryesore siç janë: ndërgjegjësimi mjedisor, efienca energjike dhe bujqësia e qëndrueshme.

Përfshirjen e Shoqërisë Civile dhe Aktoreve të tjerë:

EU4Green synon të zhvillojë njohuritë e shoqërisë civile në lidhje me shtyllat e Agjendës së Gjellbër, si dhe të inkurajojë përfshirjen dhe ekspertizën e këtyre organizatave në procese vendim-marrëse.

Zhvillimin e Financimit të Tranzicionit të Gjellbër:

Ekonomitë të Ballkanit Perëndimor do të propozohen Strategji për të financuar tranzicionin e gjellbër, duke e vendosur theksin tek financimi i qëndrueshëm, tek asimilimi i programeve financuese dhe tek angazhimi i institucioneve financiare vendore. Do të ofrohen trajnime për financën e gjellbër si për sektorët publik ashtu edhe privatë si dhe do të nxitet përafrimi i rregulloreve kombëtare me kuadrin rregullator të BE-së për Financën e Qëndrueshme.

FAKTE DHE TË DHËNA

Programi: EU4Green: Mbështet zbatimin e Agjendës së Gjellbër për Vendet e Rajonit të Ballkanit

Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi

Kohëzgjatja: 2022 – 2025

Fonde të BE-së: 10 milion EUR

Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC): 1 milion EUR

Zbatuar nga: Agjencia Austriake e Mjedisit (EAA)

Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (AGJBP):

AGJBP është udhëzuesi strategjik më i rëndësishëm në kuadër të reformave rregullatore për Rajonin, i cili e përafron këtë të fundit drejt objektivave ambicioze të BE-së siç janë rritja e përdorimit eficient të burimeve, tranzicioni në një ekonomi të pastër qarkulluese (qarkore), ndalimi i ndryshimeve klimatike, rigjenerimi i biodiversitetit si dhe reduktimi i ndotjes.

* Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 dhe Opinione dhe GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.